

QENDRA E STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE PËR ARBËRESHËT



Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave për krijimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshëtnr. 601, datë 04.09.2019 si dhe Ligjit nr. 7961, datë 12. 7. 1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, QSPA do të shpallë në faqen zyrtare të internetit konkursin për pozicionin:

PASQYRA E PUNËS

POZICIONI I PUNËS	Specialist Kërkues shkencor në fushën e letërsisë së krahasuar dhe bashkëkohore shqipe
DEPARTAMENTI	Drejtoria e Studimeve dhe Publikimeve
ADRESA E QSPA	Rruga “Skënderbej”, pll 8/3, Ap.40, Tiranë
RAPORTON TEK	Drejtori i Drejtorisë së Studimeve dhe Publikimeve

PËRSHKRIMI I PUNËS

Objekti i punës së **Specialist Kërkuesit shkencor pranë** Drejtorisë së Studimeve dhe Publikimeve është:

- Kryen studime të thelluara në fushën e tij/saj të specialitetit.
- Nxit dhe bashkërendon veprimtaritë e QSPA-së me institucione dhe qendra të tjera studimore brenda dhe jashtë vendit;
- Vendos dhe mban lidhje me shoqatat, organizatat, qendrat, përfaqësitë brenda dhe jashtë vendit të cilat kanë si objekt të veprimtarisë së tyre komunitetet Arbëreshe;
- Ndjek korrespondencën me institucione dhe organizata të ndryshme brenda dhe jashtë vendit në lidhje me studimet dhe publikimet për Arbëreshët;
- Merr pjesë në organizimin e konferencave dhe seminareve shkencorë, të cilat i mbështet me ide, përmbajtje dhe organizim.
- Bashkërendon dhe kryen përgatitjet e nevojshme në kuadër të projekteve të përbashkëta me Ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme, për thirrjen e projekteve europiane, kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Mban lidhje të drejtpërdrejta me Drejtorin për të siguruar cilësi në punët që kryhen.

Specialisti i punësuar në këtë kategori duhet të plotësojë këto kritere:

- Të zotërojë gradë/titull shkencor “Doktor” në letërsi;
- Të ketë përvojë në kërkimin kritik letrar dhe filologjik të tekstit, me interesa specifike për tekstet gjuhësore letrare arbëreshe.
- Të ketë realizuar studime të botuara në revista të specializuara edhe ndërkombëtare, mundësisht në “Scopus”.
- Të jetë i aftë të intensifikojë kontaktet me realitetet akademike ndërkombëtare, kryesisht ato italiane, që merren me studimet Arbëreshe.
- Të zotërojë diploma të tjera universitare në fushën e sipërcituar;
- Të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune në fushën e kërkimit shkencor për të cilën punësohet;

- Të ketë njohuri mbi historinë e Arbëreshëve;
- Të përmbushë kriteret e punësimit që përcaktohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- Të jetë i aftë të realizojë, përveç kërkimit shkencor në disiplinën përkatëse, një apo disa nga aktivitetet që hyjnë në objektin e punës së Drejtorisë së Studimeve dhe Publikimeve, të cilat do t'i caktohen nga eprrorët sipas nevojave të kalendarit të veprimtarive.
- Të përmbushë kriteret e punësimit që përcaktohen nga aktet ligjore dhe nën-ligjore në fuqi;
- Të jetë i certifikuar në gjuhë të huaj, minimumi niveli C1 (Italisht ose Anglisht).

AFTËSITË

- Aftësi vendimmarrëse dhe interpretuese
- Aftësi pune në grup
- Komunikim shumë i mirë
- Aftësi të mira në përballimin e punës nën presion

KUSHTET E PUNËS

MJEDISI I PUNËS

Mjedisi i punës, karakterizohet nga ambientet e përshtatshme dhe të mirë organizuara për punën kërkimore e studimore.

ORARI I PUNËS

Nga e hëna në të enjte, orari është nga ora 08:00 deri në orën 16:30.
Ditën e premte, orari është nga ora 08:00 deri në orën 14:00.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë, duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim ku shpreh interesin për të aplikuar për pozicionin e punës;
2. Jetëshkrim (CV) në formatin EuroPass;
3. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
4. Fotokopje të diplomave universitare dhe të gradës/titujve shkencorë “Doktor”;
5. Referencë nga të paktën një profesor;
6. Fotokopje të librezës së punës ose vërtetime nga punëdhënësit, të cilat vërtetojnë eksperiencën në punë;
7. Kopje të artikujve, teksteve, revista, projekte shkencore etj;
8. Certifikata që vërtetojnë zotërimin e gjuhës së huaj;
9. Vetë deklaram të gjendjes gjyqësore;
10. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve të bëhet brenda datës 17/06/2022 ora 14:00, në Zyrën e Protokollit të QSPA-së në Rruga “Skënderbej”, pll 8/3, Ap.40, Tiranë, si dhe në adresën e e-mail: info@qspa.gov.al

Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë të cilat do të zhvillohet intervista:

- Njohuri mbi ligjin nr. 80/2015 datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- Njohuri të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për fushën e mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë.
- Ligji nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore".
- VKM nr. 601, datë 04.09.2019 “Për krijimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët”.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

Faza e parë:

Në fazën e parë kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

- Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv.

Faza e dytë: Intervista e strukturuar me gojë

Intervista e strukturuar me gojë do të realizohet në datë 20.06.2023 në ambjentet e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e konkurrimit

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga QSPA-ja, për rezultatet, pas zhvillimit të intervistës me gojë (nëpërmjet adresës së e-mail).